

LIGJ

Nr. 8910, date 6.6.2002

PER RATIFIKIMIN E KONVENTES NR.150 "ADMINISTRIMI I PUNES, 1978" TE ORGANIZATES NDERKOMBETARE TE PUNES

Ne mbeshtetje te neneve 78, 81, pika 1, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa nr .150 " Administrimi i Punes, 1978" e Organizates Nderkombetare te Punes .

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3376, date 24.6.2002 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Rexhep Meidani

KONVENTA NR. 150

KONVENTA NE LIDHJE ME ADMINISTRIMIN E PUNES, ROLI, FUNKSIONET DHE ORGANIZIMIN

Konferenca e pergjithshme e Organizates Nderkombetare te Punes, e mbledhur ne Gjeneve nga organi drejtues i Zyres Nderkombetare te Punes, ne sesionin e saj te gjashtedhete e katert, me 7 qershor 1978,  
Duke iu referuar kushteve re konventave ekzistuese nderkombetare te punes dhe rekomandimeve, dhe, ne menyre te veçante, Konventa per Inspektimin ne Pune, e vitit 1947, Konventa per Inspektimin ne Pune (Bujqesia), 1969 dhe Konventa per Sherbimet e Punesimit, 1948, te cilat kane lidhje me ushtirmin e aktiviteteteve te veçanta per administrimin e punes, dhe  
Duke u nisur nga deshira per adaptimin e mekanizmave qe rregullojne udhezimet ne lidhje me gjithe sistemin e administrimit te punes, dhe  
Duke iu referuar kushteve te Konventes per politikat e punesimit, 1964, dhe Konventes per Zhvillimin e Burimeve Njerezore, 1975; duke pasur parasysh, gjithashtu, synimin per

krijimin e nje punesimi te shperblyer plotesisht dhe adekuat dhe duke konfirmuar nevojen per programe per administrimin e punes qe te punojne per kete synim dhe te zbatojne objektivat e konventave te mesiperme,

dhe Duke njohur domosdoshmerine per respektimin e plate te autonomise se organizatave te punemarresve dhe punedhenesve, duke pasur parasysh ne lidhje me kete kushtet e konventave ekzistuese nderkombetare te punes dhe rekomandimet, te cilat garantajne te drejta per te krijuar shaqata, arganizata dhe marreveshje kolektive dhe, ne menyre te veçante, Konventen e 1948 per Lirine e Shoqatave dhe Mbrojtjen e te Drejtes per t'u Organizuar dhe Konventen e 1949 per te Drejten e Organizimit dhe Marreveshjes Kalektive, te cilat ndalojne çdo nderhyrje te autoriteteve publike qe mund te kufizojne keta te drejta ose pengojne veprimtarine ligjore te tyre, dhe duke patur parasysh se organizatat e punemarresve e punedhenesve luajne nje rol esencial ne sigurimin e objektiveve per zhvillimet ekanamike, sociale e kulturare, dhe Duke adaptuar prapazime te veçanta ne lidhje me administrimin e punes, si roli, funksionet, dhe organizimi i saj, qe perben piken kater ne axhenden e sesionit, dhe Duke vendosur qe keta propozime te marrin formen e nje konvente nderkombetare, Miraton sot, me njezet e gjashte qershor te vitit nje mije e nenteqind e shtatedhjete e tete, Konventen e mepashteme, e cila do te quhet: Konventa per Administrimin e Punes, 1978.

#### Neni 1

Per qellim te kesaj Konvente:

- a) termi "administrimi i punes" kupton aktivite administrative publike ne fushen e politikave kombetarere punes;
- b) termi "sistemi i administrimit te punes" perfshin te gjitha organet administrative publike pergjegjese ose qe jane angazhuar me administrimin e punes -pavaresisht se jane departamente te ministrive ose degastereve publike, perfshire institucionet parashteterore, rajonale apo lokale ose çdo forme tjeter e nje administrate te decentralizuar -dhe çdo institucion per koordinimin e aktiviteve te organeve te tilla, per t'u konsultuar dhe per pjesemarrjen e punedhenesve e punemarresve dhe organizatat e tyre.

#### Neni 2

Anetari qe ratifikon kete Konvente mund, ne perputhje me ligjet dhe rregullat kombetare apo praktikate e vendit, t'i adresojne ose besojne aktivite te caktuara te administrimit te punes organizatave joqeveritare, vecanerisht organizatave te punedhenesve e punemarresve ose, kur eshte e mundur , perfaqesuesve te punedhenesve e punemarresve.

#### Neni 3

Anetari qe ratifikon kete Konvente mund t'i trajtojne aktivitetet e veçanta ne fushen e politikave te tij kombetare te punes sipas rasteve, te cilat, ne perputhje me ligjet dhe rregullat kombetare ose praktikate e vendit, rregullohen nepermjet negociatave direkte me organizatat e punedhenesve e punemarresve.

#### Neni 4

Çdo Anetar që ratifikon këto Konvente, në përputhje me kushtet e vendit, u siguron organizatave një funksionim efektiv në fushën e vet të sistemit për administrimin e punës, funksionet dhe përgjegjësitë e reëve koordinohen siç duhet.

#### Neni 5

1. Çdo vend që ratifikon këto Konvente duhet të marrë masat sipas kushteve të vendit për të siguruar, brenda sistemit të administrimit të punës, konsultime, kooperime dhe bisedime ndërmjet autoriteteve publike dhe organizatave me të përfaqësuara të punëdhënësve e punëmarrësve dhe, kur është e përshatshme, përfaqësuesit e punëdhënësve e punëmarrësve.
2. Në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregullat kombëtare dhe praktikën e vendit, masa të tilla do të merren në nivel kombëtar, rajonal e lokal si edhe në nivele të sektoreve të ndryshme me aktivitet ekonomik.

#### Neni 6

1. Organet kompetente brenda sistemit të administrimit të punës, sipas rastit, do të përgjigjen ose kontribuojnë për përgatitjen, administrimin, koordinimin, kontrollin dhe shqyrtimin e politikave kombëtare të punës dhe, brenda kompetencave të administratës publike, të jenë instrumenti për përgatitjen dhe zbatimin e ligjeve dhe rregullave në hyrjen e tyre në fuqi.
2. Këto organe, në mënyrë të veçantë, duke pasur parasysh standardet ndërkombëtare të punës
  - a) do të marrin pjesë në përgatitjen, administrimin, koordinimin, kontrollin dhe shqyrtimin e politikave kombëtare të punësimit, në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare dhe praktikën e vendit;
  - b) do të studiojnë dhe mbikëqyrin personat e punësuar, të papunët dhe ata që përgatiten për punë, duke pasur parasysh ligjet e rregullat kombëtare dhe praktikën e vendit në lidhje me konditat e punës dhe jetesës, kushtet e punësimit, t'u kushtojë vëmendje defekteve dhe abuzimeve për këto kondita e kushte dhe të bëjnë propozime për mënyrën e kapërcimit të tyre;
  - c) shërbimet e tyre t'i vënë në dispozicion të punonjësve dhe punëtorëve dhe organizatave të tyre përkatëse, dhe sipas rasteve, në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare apo praktikën e vendit, me qëllim që të zhvillojë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, si edhe në nivelet e sektoreve të ndryshme të aktivitetit ekonomik për konsultime dhe kooperim efektiv ndërmjet autoriteteve e organeve publike dhe organizatave të punëdhënësve e punëmarrësve, si edhe ndërmjet këtyre organizatave;
  - d) me kërkesën e tyre, do t'u japë këshilla teknike punëmarrësve e punëdhënësve dhe organizatave të tyre përkatëse.

#### Neni 7

Kur e kërkojnë kushtet e vendit, me qëllim që të plotësohen nevojat e pjesës më të madhe të punëtorëve, dhe kur aktivitete të tilla nuk janë organizuar deri tani, çdo Anetar që ratifikon këto Konvente do të përpiqet për rritjen e shtrirjes, dhe kur është e nevojshme edhe gradualisht, të funksioneve të sistemit për administrimin e punës, duke u përfshirë sa më shumë aktivitete e të realizohen në bashkëpunim edhe me komponentet e tjera të organit, që kanë lidhje me kushtet e punës dhe jetesës dhe me kategori të caktuara, të cilët, sipas ligjit, nuk janë persona të punësuar, si:

- a) qirmarres që nuk angazhojnë forca të tjera, ndares prodhimesh dhe nga kategori të njëjta të punëtorëve të bujqësisë;
- b) të punësuar vete që nuk angazhojnë forca të tjera, të angazhuar në një sektor jozyrtar siç shpjegohet në praktiken e çdo vendi;
- c) anetare të kooperativave ose ndërmarrje të ndryshme punëtorë;
- d) persona që punojnë sipas sistemeve të ngritura mbi bazën e zakoneve apo traditave krahinore.

#### Neni 8

Në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare dhe praktikën e vendit, organet kompetente, brenda sistemit të administrimit të punës, do të kontribuojnë për përgatitjen e politikave kombëtare për lidhje me çështjet ndërkombëtare të punës, të marrin pjesë në përfaqësimin e shtetit në lidhje me këto çështje dhe të kontribuojnë në marrjen e masave në nivel kombëtar në lidhje me to.

#### Neni 9

Me qëllim që të koordinohen sa më mirë funksionet dhe detyrat e sistemit për administrimin në punë, siç përcaktohet në ligjet dhe rregullat kombëtare apo praktikën e çdo vendi, Ministria e punës apo një organ tjetër i afert me të do të ketë mjetet e nevojshme për të siguruar që çdo agjenci e afert me shtetin, e cila përgjigjet për organizimin e aktiviteteve të veçanta për administrimin e punës, apo edhe ndonjë institucion rajonal apo lokal, të cilët i janë adresuar aktiviteteve të veçanta për administrimin e punës, të veprojnë në përputhje me ligjet e rregullat kombëtare dhe të zbatojnë objektivat që u janë caktuar.

#### Neni 10

1. Stafit i sistemit të administrimit të punës do të përbehet nga persona që janë kualifikuar mirë për aktivitetet që u janë caktuar, të cilët, kur është e nevojshme, të kenë mundësi të organizojnë trainime për këto aktivitete dhe të mos jenë të varur nga ndonjë influencë e jashtme jo e drejte.
2. Ky staf do të ketë statusin, materialet, mjetet dhe burimet e nevojshme financiare për të realizuar me efektivitet detyrat e tyre .

11-18: Dispozitat e fundit standarde 2

#### ANEKSI I

#### Neni 11

Ratifikimi zyrtar i Konventes duhet t'i komunikohet per regjistrimit Drejtorit te pergjithshem te Zyres Nderkombetare te Punes.

#### Neni 12

1. Kjo Konvente eshte e detyrueshme vetem per ata Anetare te Organizates Nderkombetare te Punes, ratifikimi zyrtar i te cileve eshte regjistruar tek Drejtori i pergjithshem.
2. Ajo do te hyje ne fuqi 12 muaj pas dates ne te cilen ratifikimi i dy Anetareve eshte regjistruar tek Drejtori i pergjithshem.
3. Pas kesaj, kjo Konvente do te hyje ne fuqi per çdo Anetar 12 muaj pas dates ne te cilen eshte regjistruar ratifikimi i tij .

#### Neni 13

1. Anetari qe ka ratifikuar kete Konvente mund ta denoncoje ate pas mbarimit te 10 vjeteve nga data ne te cilen ka hyre ne fuqi per here te pare Konventa, me anen e nje akti, qe i komunikohet per regjistrim Drejtorit te pergjithshem te Zyres Nderkombetare te punes. Ky denoncim nuk hyn ne fuqi deri ne nje vit pas dates ne te cilen ajo eshte regjistruar .
2. Çdo Anetar qe ka ratifikuar kete Konvente dhe qe nuk e ushtron, brenda nje viti pas mbarimit te periudhes 10- vjeçare te permendur ne paragrafin e mesiperm, te drejten e denoncimit te parashikuar ne kete nen, do te jete i lidhur per nje periudhe 10-vjeçare dhe, pas kesaj periudhe, mund ta denoncoje kete Konvente ne mbarim te çdo periudhe tjeter 10-vjeçare, ne perputhje me kushtet e parashikuara ne kete nen.

#### Neni 14

1. Drejtori i pergjithshem i Zyres Nderkombetare te Punes duhet te njoftoje te gjitha Anetaret e Organizates Nderkombetare te Punes per regjistrimin e te gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve, qe i komunikohen atij nga Anetaret e Organizates.
2. Kur njofton Anetaret e Organizates per regjistrimin e ratifikimit fe dyte qe i komunikohet atij, Drejtori i pergjithshem duhet te vere ne dijeni Anetaret e Organizates per daten ne te cilen hyn ne fuqi Konventa.

#### Neni 15

Drejtori i pergjithshem Zyres Nderkombetare te Punes duhet t'i komunikojte per regjistrim, sipas nenit 102 te Kartes se Kombeve te Bashkuara, Sekretarit te pergjithshem te Kombeve te Bashkuara, te gjitha veiyorite e te gjitha ratifikimeve dhe akteve te denoncimeve te regjistruara nga ai, ne perputhje me dispozitat e paragrafit te mesiperm.

#### Neni 16

Keshilli Drejtues i Zyres Nderkambetare te Punes duhet te paraqese ne Kanferencen e pergjithshme, ne kahen qe e gjykan te nevojshme, nje rapart per zbatimin e kesaj Kanvente, si dhe te shqyrtaje nevajen e vendasjes ne pragramin e Kanferences te ceshtjes se ndryshimit te saj te pjesshem apa te plate.

Neni 17

1. Kur Konferenca miraton nje konvente te re, qe ndryshon pjeserisht apo plotesisht kete Konvente, atehere, pervec kur konventa e re parashikon ndryshe:

(a) ratifikimi nga nje Anetar i konventes se re, sipas ligjit, prezumon denoncimin e menjehershem te kesaj Konvente, pavaresisht nga dispozitat e nenit 3 me siper, nese dhe kur Konventa e re hyn ne fuqi.

(b) nga data kur konventa e re hyn ne fuqi, kjo Konvente do te pushoje se qeni e hapur per ratifikim nga Anetaret.

2. Kjo Konvente do te mbetet ne fuqi, ne çdo rast, ne formen dhe permbajtjen aktuale per ata Anetare qe e kane ratifikuar ate, por nuk kane ratifikuar konventen e re.

Neni 18

Versionet anglisht dhe frengjisht te tekstit te kesaj Konvente kane fuqi te barabarte.